

MENDIM PARALEL

Unë, Genta Tafa (Bungo), anëtare e trupit gjykues që ka kryer procesin të rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Çlirim Sino, duke rënë dakord me vendimmarrjen përfundimtare në kushtet që ndodhen aktet, mendoj se vlerësimi i disa fakteve duhet të ishte bërë ndryshe, duke qenë më shterues.

Duke mos qenë dakord mbi një pjesë të qëndrimit të mbajtur nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, që ka çuar në disa konkluzione që nuk më gjejnë dakord, në vijim, po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe nga arsytimi i vendimit të Komisionit.

Për sa më lart, në konkluzion për vitin 2016, sipas mendimit të shumicës, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme financiare, në masën prej – 2,044,199 lekë. Shumica vlerëson se pamjaftueshmëria e konstatuar më lart, e burimeve të ligjshme financiare, çon në deklaram të pamjaftueshëm që kualifikohet sipas pikës 5, shkronja “b” e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke passjellë aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me këtë rezultat negativ të shumicës nuk jam dakord, pasi nga analiza financiare konstatohet se bashkëshortja e subjektit në vitin 2016 ka një disponibilitet neto si person fizik në vlerën 1,607,897 lekë. Kjo shumë nuk rezulton të jetë përfshirë në analizë financiare, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga bankat e nivelit të dytë nuk rezulton të jetë depozituar dhe më pas tërhequr në asnjë prej këtyre bankave. Gjithashtu, kjo shumë nuk rezulton gjendje as në pasqyrat financiare të personit fizik për vitin pasardhës, duke mbetur e paqartë destinacioni final i kësaj shume. Nëse kjo shumë do të përfshihej në analizë financiare, rezultati negativ për këtë vit do të ishte në një vlerë afërsisht 436,303 lekë, e cila bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke aplikuar parimin e proporcionalitetit, nuk përbën shkak për klasifikimin si deklarim i pamjaftueshëm.

Gjithashtu, për sa kohë subjekti ka provuar të kundërtën e barrës së provës¹ të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, duke provuar që ai kishte të ardhura të ligjshme për depozitimet e kryera, të cilat kishin kontribuar në krijimin e depozitës në shumën 43.000 euro, jam e mendimit që duhej të zgjerohej hetimi për të përcaktuar saktësisht destinacionin e shumës 1,607,897 lekë dhe me pas, në varësi të hetimit, t'i kalohej barra e provës subjektit për mungesë burimesh të ligjshme për vitin 2016, me qëllim ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes nga ana e tij, në respektim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

ANËTARE ME MENDIM PARALEL

Genta Tafa (Bungo)

¹ E cila lidhej me krijimin e depozitës në vlerën 43.000 euro në BKT.